

VENDIM
Nr. 209, datë 11.12.2020

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA” SHPK, NR. 322, SERIA F15, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 159, DATË 28.12.2015

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “d”; nenit 5, pika 1, germa “d”; nenit 13 dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 11.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 131/2 prot., datë 9.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 172, datë 4.11.2020, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., nr. 322, seria F15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 159, datë 28.12.2015.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, u krye njoftimi në median e shkruar, me shkresën me nr. 62/33 prot., datë 6.11.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 1183 prot., datë 9.11.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., me shkresën nr. 11120/extra prot., datë 12.11.2020, dërguar në ERE me e-mailin e po të njëjtës datë, ka përcjellë të gjithë dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., është mbajtëse e licencës me nr. 322, seria F15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendim të Bordit të ERE-s nr. 159, datë 28.12.2015, me afat 5-vjeçar.

- Vlefshmëria e licencës së shoqërisë “Energia Gas and Power” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, përfundon në datën 28.12.2020, dhe shoqëria e ka depozituar aplikimin e saj në ERE, brenda afatit që përcakton neni 16, pika 1, sipërcituar (datë 22.10.2020).

- Dokumentacioni i aplikimit është tërësisht i plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë rinovimin e licencës nr. 306, seria FK15, të shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit nr. 159, data 28.10.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 29.12.2020.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti